



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE**  
**MBROJTJES SE KONSUMATORIT**  
**SEKRETARI I PERGJITHSHEM**

---

---

Nr. .... Prot.

Tirane, me / /2010

**Lenda :**        *Monitorimi i buxhetit 9 mujor 2010*

**Drejtuar:**                **MINISTRISE SE FINANCAVE**  
**DREJTORISE PERGJITHSHEME TE BUXHETIT**  
**TIRANE**


**Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**, gjatë 9 mujorit të vitit 2010 ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, e konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- ❖ Siguria ushqimore, Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun.
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshem i Tokës Bujqësore

Buxheti 9 mujor 2010 , i planifikuar për këto 6 programe, është realizuar në masën 54% përqind, i paraqitur në tabelën e mëposhtme: Buxheti vjetor 2010 i rishikuar është 5425 miljon lekë dhe është realizuar si 9 mujor 2010 në krahasim me planin vjetor 2917 miljon lekë të detajuar sipas programeve , paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri i programit	Buxheti 2010(mln leke)	Struktura Ne %	Fakti i 9 mujorit te 2010		
				Ne mln leke	Ne % ndaj buxh	Struk ne %
1	Planif menaxh, administrimi	277	5,1	181	65	6,2
2	Siguria ushq. mbro. konsumat.	1486	27,4	875	58,9	30
3	Infrastrukt e ujitjes, kullimit	1719	31,7	823	48,8	28,1
4	Zhvillimi rural	1693	31,2	901	53,2	31
5	Keshillimi dhe inf. bujqesor	241	4,4	134	55,6	4,6
6	Menaxh i tokes bujq.	8,5	0,2	3	35,3	0,1
	<b>Totali</b>	<b>5425</b>	<b>100</b>	<b>2917</b>	<b>53,8</b>	<b>100</b>


Rreth 30 përqind e totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë 9 mujorit të vitit 2010 e zenë shpenzimet për programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, ndjekur nga shpenzimet për programin “Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit”, me rreth 28,1 përqind. të totalit të shpenzimeve faktike dhe programi “Zhvillimi rural duke mbështetur produktet bujqesore dhe blegtorale” me rreth 31 përqind të totalit të shpenzimeve faktike.



Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2010 dhe realizimit faktik për 9 mujorin e vitit 2010, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

*Ne %*

Nr	Emri i programit	Struktura e Shpenzimeve sipas PBA-se 2010	Struktura e Shpenzimeve sipas Buxhetit 2010	Struktura e Shpenzimeve faktike 9 /m vitit 2010
1	Planif menaxh, administrimi	4.1	5.1	6.2
2	Siguria ushq, mbr. konsumat.	22,5	27,4	30
3	Infrastrukt e ujitjes, kullimit	40,4	31,7	28,1
4	Mbeshtetja prodh bujq-bleg	28.0	31,2	31
5	Keshillimi dhe inf. bujqesor	4,8	4,4	4,6
6	Menaxh i tokes bujq	0.3	0.2	0,1
	<b>Totali</b>	<b>100.0</b>	<b>100</b>	<b>100</b>



## Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

### 1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Realizimi i shpenzimeve 9 mujore të vitit 2010 për këtë program, që përfaqëson rreth **6,2 përqind** të realizimit 9 mujor të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 71 përqind
- Shpenzimet kapitale 42,3 përqind
- **Gjithsej 65,3 përqind**

Për vitin 2010 parashikuar 6 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2010 ne mln leke	Realizimi i 9 mujorit 2010		
		Ne mln leke	Ne %	Statusi i produktit
Funks i kapac. menaxh per impl. e pol. bujq.	5	3,5	70	Pjesrisht
Ngritja profesionale e stafit	169	114	67,4	Pjesrisht
Menaxhimi i pergji. i institucionit	39	30	77	Pjesrisht
Detyrime per antarsimi ne org. nderk.	13	12,5	96	plotesisht
Permiresimi i kushteve te punes	22	4	18	Pjesrisht
Vazhdimi i Projektit te intranetit	30	17	57	Pjesrisht
<b>TOTALI</b>	<b>278</b>	<b>181</b>	<b>65</b>	

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit vjetor si 9 mujor janë realizuar 68 %, sigurimet shoqërore 65 %, shpenzime operative 81 %, investimet 42 %.

## 2. Programi “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”.

Ky program është i një rëndësie të vecantë dhe ka si objektiv kontrollin e plotë të situatës epizootike veçanërisht nga sëmundjet zoonotike me impakt në shëndetin publik, duke synuar krijimin e një popullacioni kafshesh të shëndetsuara nga sëmundjet plasje,tbc,bruceloze; garantimin e një situatë të pastër fitosanitare nga parazitët karantinorë në zonat e lira për arritjen e një prodhimi të pastër nga parazitët dhe mbetjet e PMB të mundshëm për konsum dhe eksport, arritja e standarteve të BE në produkte ushqimore, me origjinë shtazore dhe bimë për rritjen e sigurisë së tyre në tregun e brendshëm dhe në tregun ndërkombëtar.

Realizimi i shpenzimeve 9 mujore për këtë program, që përfaqëson rreth 30 përqind të totalit të buxhetit të kësaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korentë 67 përqind
- Shpenzimet kapitale 5 përqind
- **Gjithsej 59 përqind**

Për vitin 2010 janë parashikuar 21 produkte, nën këtë program, performanca e të cilëve jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2010 në mln leke	Realizimi 9 mujori i 2010		
		Në milione leke	Në %	Statusi i realizimit
	0	0	0,0	
Kafshe bujqësore dhe produkte me origjinë prej tyre të evidentuara për mbetjet:molusqe bivalente dhe ujra	11	4,4	40	Pjesërisht
Sëmundje me karakter përhapës dhe të monitoruara në gjithë vendin	6,5	3	46	Pjesërisht
Derra të vaksinuar k/murtajës klasike	3,6	2,7	75	Pjesërisht
Të imta të vaksinuara k/brucelozës Rev 1	29	11,8	40,7	Pjesërisht
Gjedh të vaksinuar k/brucelozës	2,8	0,7	25	Pjesërisht
Kafshe të imta dhe të gjurmëtuara për bruceloze	24,8	15,5	63	Pjesërisht
Gjedhe të gjurmëtuara për tuberkuloz	11,4	9	79	Aspak
Kafshe gjedh të gjurmëtuara për bruceloze	3,4	0,9	26,5	pjesërisht
Kafshe të llojeve të ndryshme të vaksinuar k/plasjes-gjedh	9	5,0	55,5	pjesërisht
Kafshe të llojeve të ndryshme të vaksinuar k/plasjes- imta etj.	36	24	66,7	pjesërisht
Kafshe imta të infektuara të eliminuara	16	7	44	pjesërisht
Kafshe gjedh të infektuara të eliminuara	21	12	57	pjesërisht
Zone e lira e prodhimit të patates e monitoruar	1	0	0	Aspak
Sipërfaqe të trajtuara kundër miut të rave dhe karkalecit	12,8	4	31	pjesërisht
Rrenje ullinj dhe pemë frutore të trajtuara k/mizës dhe flutres së bardhë të malit	15	0,4	2,7	pjesërisht
Pemë frutore të asgjësuar si të infektuara	1,2	0	0	Aspak
Laboratore të sig.ushqimore të pajisur me reagentë	22,1	9,1	41,2	Pjesërisht
ISUV I fuqizuar me kapacitet laboratorikë, rikonstruksion	153	14	9,2	Pjesërisht
Shpenzime operative				
DRBUMK të fuqizuara me baze materiale të rikonstruktura	1006	703	70	Pjesërisht
Financim i huaj	50	0	0	Aspak
Demshperblim në rastin e permbytjeve në Shkoder	49	49	100	plotësisht
<b>TOTALI</b>	<b>1486</b>	<b>875</b>	<b>59</b>	

Qëllimi i politikës në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit është krijimi i një sistemi me funksion të plotë “nga ferma në tavolinë”, kuadër i plotë ligjor në funksion të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, të kontrollit të plotë të sëmundjeve në kafshë dhe parazitëve të dëmshëm në bime.

Kontrolli i plotë i situatës epizootike veçanërisht nga sëmundjet zoonotike me impakt në shëndetin publik, duke synuar krijimin e një popullacioni kafshësh të shëndetësuar nga sëmundjet plasje, tbc, brucelozë ; garantimi i një situatë të pastër fitosanitare nga parazitët karantinorë në zonat e lira për arritjen e një prodhimi të pastër nga këta parazitë dhe mbetjeve të PMB –ve të mundshëm për konsum e eksport , realizimi 100% i programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve në kafshë, monitorimit të ujrave e molusqeve, arritja e standardeve të BE në produkteve ushqimore, me origjinë shtazore e bimore për rritjen e sigurisë së tyre në tregun e brendshëm dhe në tregun ndërkombëtar, aftësimi i shërbimit veterinar, fitosanitar dhe i sigurisë ushqimore në kontrole e inspektive, janë objektivat e veprimtarisë në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Janë realizuar për periudhën e deritanishme një sërë aktiviteteve në kuadër të plotësisht të prioritetit afatshkurtër dhe afatmesëm *mbi arritjen e përmirësimeve thelbësore për sa i takon sigurinë e ushqimeve dhe përmirësimin e kushteve fitosanitare dhe veterinare në përputhje me kërkesat e BE-së vecanërisht për produkte me potencial të fortë eksportues*

Janë në proces aktivitetet mbi masat profilaktike veterinare e fitosanitare, programi i monitorimeve të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujrave e molusqeve bivalve.

### **Vërejmë:**

Produktet e përfutuara për periudhën 9 mujore, parashikuar në PBA për vitin 2010 të pasqyruara në aneksin bashkëngjitur janë realizuar si më poshtë,

- Kontrolli i situatës epizootike lidhur me sëmundjet zoonotike të mbështetura nga shteti nëpërmjet masave profilaktike sipas kalendarit vjetor të parashikuar është realizuar mbi 90% të planifikimit për periudhën dhe është në proces gjatë gjithë vitit ( gjurmime, vaksinime, eliminime të kafshëve të infektuara). Realizimi i plotë i këtyre produkteve për periudhën do të kryhet me ardhjen e biopreparateve veterinare, për të cilat është realizuar tenderi. Ritheksojmë se jo të gjithë masat profilaktike janë pasqyruar në tabelat e buxhetit. Kjo për arsye se lëvrimi i fondit bëhet në një kohë më të vonshme se koha e kryerjes së masës profilaktike dhe pasyrimi i masave të realizuara në tabelë varet nga lëvrimi i fondeve veterinare.( produkti E, F, G, H, I, J, K)
- Realizimi i programeve të monitorimit, është një proces i vazhdueshëm dhe analitik vjetor. Për periudhën monitorimi i mbetjeve si dhe monitorimi i ujrave e molusqeve është realizuar në përputhje me programin. (produkti C). Monitorimi i sëmundjeve ka filluar dhe është në proces. Vazhdon monitorimi i sëmundjes së salmonelozës në shpendë dhe është në proces monitorimi i sëmundjes së tërbimit dhe pseudopestit. Po ashtu kryhet rregullisht monitorimi i sëmundjes së brucelozës dhe

sëmundjes së tuberkulozit. Akoma nuk ka filluar monitorimi i sëmundjeve të tjera si BSE.

- Luftimi i parazitëve dhe dëmtuesve në bujqësi është përqëndruar vetëm në luftimin e miut të arave dhe karkalecit të cilat janë realizuar sipas planifikimit. Për produktet e tjera çdo aktivitet varet nga realizimi i tenderave (produkti L,M, N,O).
- Produktet lidhur me investime në bazë laboratorike, në konstruksione janë në proces për sa i takon pajisjeve laboratorike të ISUV-së dhe janë realizuar rikonstruksione në qarkun e Elbasanit, Beratit, Korçës, Vlorës, Kukësit. (produkti R, S).
- Janë realizuar shpenzimet operative, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në Buxhetin 2010 (produkti R, S).

### 3. Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”

Ky është një nga programet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, si një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor. Realizimi i shpenzimeve 9 mujore për këtë program, që përfaqëson rreth 36,2 përqind të totalit të buxhetit vjetor të kësaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet Korente	69	perqind
• Shpenzimet kapitale	27,4	perqind
• <b>Gjithsej</b>	<b>47,9</b>	<b>perqind</b>

- ❖ Në zbatim të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin” i ndryshuar, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i infrastruktures së kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, është përgjegjësi e MBUMK-es, që realizohet nepermjet aktivitetit të Bordeve të Kullimit me financim nga buxheti i shtetit.
- ❖ Detyrat e mesiperme mbulojnë nga programi Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja në një sipërfaqe **ujitese rreth 360 000 ha** dhe që përbëhet kryesisht nga 2000 km kanale të parë dhe 6000 kanale të dytë; dhe **kulluese 280 000 ha** me nga 2000 km kanale të parë dhe 2700 km. të dytë. Ky program financohet si nga buxheti i shtetit ashtu dhe nga Banka Botërore nepermjet Projektit të Menaxhimit Burimeve Ujore.

Në 9 mujin e vitit 2010 buxheti të këtij programi ju shtua limiti buxhetor me VKM nr.173 , date 10.03.2010 me shtesë investimesh prej 229 milion leke, për disa nderhyrje emergjente në digat e rezervuareve dhe gjithashtu gjatë muajit qershor janë përdorur 75 milion leke nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për rehabilitimin e skemave ujitese.

Për vitin 2010 janë parashikuar 20 produkte.

Ne vijim te ndryshimeve te programit 04240 “Menaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjes” gjate 9 mujorit i cili u zvogelua me 676,257,152 leke , sqarojme se edhe me vone kane vazhduar ndryshimet ne kete program.

Keto ndryshime kane te bejne me heqjen e disa objekteve dhe futjen per financim te disa objekteve te tera qe kapin vleren 108 milion leke dhe i parkasin nderhyrjeve emergjente ne zonen e Shkodres. Keto objekte jane:

	ne leke	
Rehabilitimi I Argjinatures se Çasit	50,000,000	Shkoder
Rehabilitimi I kanalit te Murtemzes (Ura e Gjo Lulit- Keneta e Vilunit)	30,000,000	Shkoder
Ndertimi argjinatures ne Darragjat	20,000,000	Shkoder
Rehabilitimi I argjinatures Shirq-Belaj, Luarz-Pentar, Reç-Pulaj	5,000,000	Shkoder
Rikonstruksioni I paneleve elektrike te hidrovorit Velipoje (Plazh Velipoje)	3,000,000	Shkoder

Pervec argjinatures se Çasit qe eshte ne fazen e prokurimit ne te gjithë objektet e tjera puna ka filluar.

Ne objektet e tjera situata paraqitet si me poshte:

Per 40 objektet rehabilitimi i digave, ka filluar likujdimi i punimeve per 25 prej tyre dhe vazhdon te punohet ne 15 te tjere.

Per 44 objekte te ujitjes vazhdojne procedurat e likujdimit te punimeve ne 35 prej tyre dhe ne 9 objekte kjo procedure akoma nuk ka filluar

Gjithashtu per 2 objekte te medha qe jane rehabilitimi i hidrovorin Sheq ne Fier dhe hidrovorit Butrint ne Sarande me fond limit 100 milion leke akoma nuk eshte bere furnizimi me paisje makineri per te cilat eshte dhene ky financim, pasi jemi ne pritje te ardhjes nga prodhuesi te tyre.

Ne lidhje me shpenzimet te destinuara por mirembajtjen e rrjetit te kanaleve te kullimit dhe riparimin e hidrovoreve mund te themi se ato jane drejt perfundimit.

- ❖ Shpenzimet per pagat dhe sigurime shoqerore si 9 mujor jane realizuar 71,5 % te fondit vjetor te planifikuar ,shpenzimet operative 67,5 % ndersa investimet si realizim financiar paraqitet ne 27,3 % .
- ❖ 31 milion leke eshte realizimi i financimit te huaj te ketij projekti ne masen 17% .

Produkti	Buxheti 2010 ne mln leke	Realizimi 9 mujori i 2010		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
<b>Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes</b>				
Rrjete te permirsuar te kanaleve te kullimit	30	4	13,3	Pjesrisht
Kanale kryesor kulluese,kolektorn dhe grykederdhjet e tyre ne det te pastruara nga depozitimet dhe barishtet	258	120	46,5	pjesrisht
Kanale kullimi te mirmbajtura ne menyre rutine	17	10	58,8	pjesrisht
Inspektime teknike te infrastructures se kullimit te zones nen sherbim prej 280000 ha	65	39	60	pjesrisht
Rrjete te kanaleve ujitewse te permirsuar pjesrisht	113	60	53	pjesrisht
Rrjete te kanaleve ujitjese te permirsuar plotesisht	224	48	21,4	pjesrisht
Dig ate rezervuareve te rehabilituara pjesrisht	135	50	37	pjesrisht
Kanale kryesore ujitese te mirmbajtura	28	14	50	pjesrisht
Sherbim ujitje me stacione pompimi	2	2	100	plotesisht
Inspektime teknike te infrastructures ujitese te zones nen sherbim prej 360000 ha	28	19	67,8	pjesrisht
Inspektime teknike te digave	77	54	70,1	pjesrisht
Rrjete ujitese te transferuara tek organizatat e perdoruesve te ujit	38	24	63,2	pjesrisht
Argjinatura te reja te ndertuara	82	59	71,9	pjesrisht
Argjinatura te rikonstruktura	77	20	25,9	pjesrisht
Argjinatura te rehabilituara	44	25	56,8	Pjeserisht
Argjinatura te mirmbajtura ne menyre rutine	18	12	66,6	pjesrisht
Inspektime teknike te argjinaturave lumore dhe detare (rreth 850 km argjinature)	20	15	75	Pjesrisht
Hidrovore te rikonstruktura dhe rippershtatur	126	16	12,7	Pjesrisht
Sherbimi kullimit me ngritje mekanike me hidrovor	327	225	69	Pjessrist
Inspektime teknike te hidrovoreve	10	7	70	Pjesrisht
<b>TOTALI</b>	<b>1719</b>	<b>823</b>	<b>48</b>	

#### 4. Programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor e blegtoral, agroindustrine dhe marketingun”.

Realizimi i shpenzimeve 9 mujore per kete program, qe perfaqeson rreth 31 perqind te totalit te buxhetit te kesaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si me poshte:

- Shpenzimet korrente 51,5 perqind
- Shpenzimet kapitale 57,7 perqind
- **Gjithsej 53,2 perqind**

Ne kete program jane parashikuar 12 produkte, ecuria e te cilave jepet nga tabela:

Produkti	Buxheti 2010 ne mln leke	Realizimi 9 mujori 2010		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Ruajtja e resurseve gjenetike ne ferme (buajt, imtakrimbi I mendafshit)	7,6	2	26,3	Plotesisht
Pjesemarrje ne panaire kombetare e nderkombetare	9,6	5,9	61,5	Pjeserisht
Ndertim tregje dhe thertore dhe pajisje me impjante te tyre	91,6	56,9	62,1	Pjeserisht
Studime	5,5	2,5	45,5	Pjeserisht
Mbeshtetje me kosto locale e tvsh (SDRMA)	69	35,6	51,6	Pjeserisht
Rritje e sip.me kultivar te certifikuar, rritje eksporti dhe cilsise	31	20,2	65,2	Pjeserisht
Reduktimi I varferise dhe rritje ekonomike ne zonat malore (SDRMA)	240	172,5	71,8	Pjeserisht
Botimi , buletini bujqesor	1,8	0,8	44,4	Pjeserisht
Skema mbeshtetje per zhv. e bujq. me peme frutore vreshta e ullinj	1037	523,2	50,5	Pjeserisht
Rritje e kontrollit dhe Certifikim fidanash me farera dhe fidane	30	17	56,7	Pjeserisht
Mbeshtetje strukturore per skemat ndihmese ne bujqesi	104,3	64,2	61,6	Pjeserisht
Krijimi seres per prodhimin e fidaneve	58,7	0	0	aspak
Regjistrimi I te gjitha sip.me vreshta (kadastra e vreshtarise dhe veres)	6,7	0,08	1,2	pjeserisht
<b>TOTALI</b>	<b>1693</b>	<b>901</b>	<b>53,3</b>	

#### Per produktet e ketij programi:

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2010, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agroindustrialisë dhe marketingut” ju alokuan gjithsej **2088180 mijë lekë** dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente 1.610.299 mijë lekë
- Shpenzime kapitale 477.881 mijë lekë

Realizimi i fondit (ndaj vjetorit) si 9 mujor paraqitet në masën 53%.

#### Realizimi sipas produkteve :

**1.Për “ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë“.** Me VKM nr. 436 date 02.06.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr.1634 datë 17.12.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”, janë përcaktuar të gjitha procedurat dhe tarifat për këtë qëllim. Pagesa kryhet pas verifikimit në 6 mujorin e dytë të vitit. Aktualisht theksojme se ka perfunduar verifikimi ne tre qarqet (Fier, Elbasan dhe Tiranë) qe për vitin 2010 kane fonde te alokuara për 123 krerë buaj.

Gjithashtu mbështetur në VKM nr.1708 datë 29.12.2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr.4 datë 18.08.2009; janë parashikuar 4.5 milion lekë për financimin e racave në rrezik zhdukje për rreth 2200 krerë në pothuajse të gjitha qarqet e vendit. Disbursimi i fondit në këtë zë pritej te fillonte në 6 mujorin e dytë, pas perfundimit te procesit te

matrikullimit të imtat. Aktualisht ky proces rezulton i perfunduar vetem ne qarkun e Korçes.

Fondi i planifikuar po në këtë zë për krimbin e mëndafshit është përdorur pothuajse plotësisht.

**2.Pjesëmarrja në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare:** Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2010 janë planifikuar të mbështeten 6 panaire ndërkombëtare dhe 4 panaire lokale gjithsejt 9,5 milion leke..

Deri tani është realizuar pjesëmarrja në 2 panaire ndërkombëtare, atë të produkteve BIO në Gjermani dhe atë të verërave në Itali, si dhe panairin lokal të Fierit, Dibrës, Korçes dhe Shkodrës. Eshtë realizuar gjithashtu pjesëmarrja ne panairin nderkombetar “Agrobiznes 2010” ne Tirane ne datat 24-26 Shtator 2010. Është kryer gjithashtu pagesa për pjesëmarrje ne panairin nderkombetar “Maching 2010” qe do te organizohet ne Milano ne Itali.

Realizimi i fondit është 62%ne vleren 5,9 milion leke, pa perfshire pagesen qe eshte bere per pjesëmarrje ne panairin e Milanos.

**3.Ndërtim tregjesh, thertoresh dhe paisje me impjante:** Është parashikuar që gjatë këtij viti të përfundojë financimi për ndërtimin e tregut të Lezhës, Matit dhe Hasit, si dhe atij të Gjirokastrës (vazhdime nga 2009). Diferencat janë parashikuar të mbulohen nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me vlerë 91.6 milion lekë dhe u janë çelur bashkive përkatëse. Theksojmë se procedurat e ndërtimit, aktualisht kanë përfunduar për të tre tregjet, përveç Gjirokastrës qe eshte ne proces perfundimi nga Bashkia.

**4.Studime.** Për vitin 2010 është parashikuar studimi i ndërtimit të zyrave të AZHBR; ai i ndërtimit të serës në QTTB Vlorë si dhe pagesat për dy studimet e pa financuara plotësisht të vitit 2009 për:Vlerësim monitorim për skemën e subvencionit dhe studimi i plotë i ullirit. Këto dy të fundit janë realizuar në masën 100%. Ndërkohë qe ka perfunduar gjithashtu studimi nga AZHBR-ja (por nuk ka kaluar pagesa ne thesar) dhe fondi për studimin e serës konsiderohet i lirë pasi është kryer nga punonjësit e vetë QTTB-së.

**5.Mbështetje me kosto lokale e TVSH për projektin SDRMA:** Kosto lokale, TVSH dhe financim i huaj për projektin SDRMA, është realizuar përkatësisht 48%; 58% dhe 98%. Janë në proces një sërë kontratash të punimeve civile si: rrugë rurale, kanale vaditëse, lerat e bagëtive, etj si dhe grandet në mbështetje të fermerëve dhe agropërpunuesve dhe skemat e mbështetjes së kredisë. Eshtë realizuar dhe nje pjese e konsiderueshme e fondit te planifikuar si financim i huaj (IPA 2008) per projektin e “Implementimit te Strategjise Kombetare te Zhvillimit Rural”, por shkresa zyrtare e konfirmuar per vleren e disbursuar vjen ne fund te vitit.

**6.Rritje e sipërfaqes së kultivarëve të certifikuar, rritje e eksportit dhe e cilësisë (AKDC).** Produkt ky i cili realizohet nga Agjensia Kombëtare e Duhan Cigareve. Realizimi në total i këtij zëri paraqitet në vlerën 59%. Eshtë punuar deri tani në drejtim të përmirësimit të prodhimit përmes futjes së kultivarëve të mirë të farës së duhanit për

monitorimin tërësor të prodhimit, grumbullim-përpunimit dhe eksportit. Po punohet dhe në drejtim të përditësimit të të dhënave të regjistrimit Kombëtar të Prodhuesve të duhanit. Për vitin 2010 është parashikuar dhe rritja e sipërfaqes së mbjellë me duhan krahasuar me vitin 2009.

**7. Skema mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë me pemë frutore e vreshta:**

Për vitin 2010 për skemat është planifikuar fondi prej 1037 milion lekë, nga të cilat 600 milion vetëm për skemën e ullirit. Është parashikuar të mbillen rreth 1000 ha me vreshta dhe pemë frutore si dhe 2400 ha me ullinj. Ka filluar puna për verifikimin e aplikimeve të ardhura për skemat duke bërë të mundur fillimin e disbursimeve të fondeve pas procesit të verifikimit dhe kontrollit në vend të aplikimeve të kryera. Kështu deri tani janë mbështetur 4063 projekte me një vlerë prej 523177 mijë lekë. Ky fond është dhënë për: mbjelljet në ullishte 2858 projekte ; në pemtore 973 projekte; në vreshta 198 projekte; etj.

**8. Botime, publikime për statistikën:** Realizimi i këtij fondi është në një masë të ulët pasi ka përfunduar vetëm botimi i vjetarit statistikor vjetor të vitit 2009 dhe pritjet të kryhen botimet dhe shtypshkrime nga DRMBUMK; proces ky i cili perfundon ne fund te 4 mujorit te trete te vitit.

**9. Rritje e kontrollit dhe çertifikimit të farërave dhe fidanëve:** realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve. Realizimi i fondit për 9 mujorin është 58%. Jemi në fazën e provave eksperimentale të testimit, dhe plotësimit të fishave të kontrollit të cilat përdoren për kontrollin e fidanëve të ullirit, të pemëve frutore dhe hardhive. Duke pasur një rritje në mbjelljet e kulturave bujqësore për të cilat jepet subvencion per fermerët është planifikuar të rritet dhe numri i çertifikimeve dhe testeve. Shlyerja do te kryhet ne fund te vitit.

**10. Mbështetje strukturore për skemat ndihmëse në bujqësi:** përfshihet fondet e planifikuara për Agjensinë e Zhvillimit Bujqësor Rural e cila zbaton skemat mbështetëse në bujqësi. Realizimi deri tani paraqitet në vlerën 62% (paga, sigurime dhe shpenzime korente). Lidhur me fondet e planifikuara per studimin e ndertimit te zyrave te reja per AZHBR, theksojme se jemi ne procesin e lidhjes se kontrates me fituesin.

**11. Krijimi i serës për prodhimin e fidanëve:** Në mbështetje të objektivit strategjik të qeverisë dhe MBUMK-së për mbjelljen e ullinjve dhe studimit të plotë të kryer për këtë qëllim është parashikuar ngritja e një sere për prodhimin e fidaneve pranë QTTB-së Vlorë. Ka përfunduar studimi për këtë qëllim nga vetë specialistët e QTTB-së Vlorë dhe ka përfunduar procedura e tenderimit. Pritet disbursimi total ne fund te vitit.

**12. Rregjistrimi i të gjithë sipërfaqeve me vreshta (kadastra e vreshtarisë dhe verës).** Me përfundimin e projektit të BE-së për krijimin e kadastrës së vreshtarisë dhe verës, duhet të përfundojë dhe të vazhdojë puna për rregjistrimin e gjithë sipërfaqes së mbetur dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngritur. Është parashikuar një fond prej 6.7 milion lekë për QTTB Fushë-Krujë për këtë qëllim. U parashikua qe këtë vit te rregjistroheshin rreth

2000 njësi vreshti, por per arsye te mungeses se stafit te kualifikuar per kete qellim ky fond nuk u perdor nga QTTB Fushe Kruje.

## 5. Programi “ Keshillimi dhe informacioni bujqesor ”

Realizimi i shpenzimeve 9 mujore për këtë program, që përfaqëson rreth 4,6 perqind te totalit te buxhetit te kesaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet Korente 58,6 perqind
- Shpenzimet kapitale 34,6 perqind
- **Gjithsej 55,6 perqind**

Nen kete program jane parashikuar 11 produkte, ecuria e te cilave jepet nga tabela bashkengjitur.

Produkti	Buxheti 2010 ne mln leke	Realizimi 9 mujori I 2010		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Ndertime te reja ne QTTB te realizuara	10	6	60	pjesrisht
Baza eksperimentale prodhuese te rrethuara	4,3	1	23,2	plotesisht
Teknologji dhe paketa teknologjike te permirsuar dhe studime te realizuara	117,2	78	66,6	<b>pjesrisht</b>
Fermere te kontaktuar dhe ofruar sherbime ekstensionit	50,2	34	67,7	<b>plotesisht</b>
Instalim sistemi ujites	5	0	0	aspak
Paisje dhe orendi .per QTTB. Te blera	2,6	0,3	11,5	<b>pjesrisht</b>
Te ardhura nga QTTB te realizuara	43,3	12	27,7	<b>plotesisht</b>
Paisje elektronike te blera	0,3	0,3	100	plotesisht
Rikostruksione te parashikuara te realizuar	4,0	2,4	60	<b>pjesrisht</b>
Paisje lab. Te blera	2,4	0	0	aspak
Mjete dhe agregat bujqesor te blere	2	0	0	aspak
<b>TOTALI</b>	<b>241,3</b>	<b>134</b>	<b>55,5</b>	

Në programin “Këshillimi & Informacioni Bujqësor” përfshihet financimi i Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor, aktivitetet e të cilave ndiqet nga sektorët përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) gjatë 9 mujorit të vitit 2010 e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave dhe programit të punës të vitit 2010.

Për periudhën 9 mujore të vitit 2010 produktet e këtij programi janë realizuar si vijon:

**Produkti : Teknologji, paketa teknologjike te përmirësuara dhe studime të ofruara.** Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt janë realizuar në masën 67% krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2010 janë planifikuar 10 teknologji/paketa teknologjike. Realizimi i ketyre teknologjive/paketave teknologjike eshte në proces deri

ne fund të vitit. Aktivitetet që i shërbejnë **produktit** janë studime mbi teknikat dhe teknologjitë në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e hallkave të larta si dhe prodhimi i hallkave të larta të farave dhe fidanëve Super- Super Elite (SSE) dhe Super Elite (SE).

**Produkti: Fermerë të kontaktuar dhe ofrime shërbime ekstensionit.** Shpenzimet për këtë produkt janë realizuar 67 % krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Aktivitetet që kontribuojnë në realizimin e këtij produkti janë: realizimi i 26 kërkimeve në nivel ferme, përgatitja dhe shpërndarja e materialeve divulgative për fermerët si dhe përgatitja e shpërndarja e revistës “Bujqësia Shqiptare” dhe “Buletinit të Shkencave Bujqësore”. Aktualisht janë përgatitur dhe botuar 2 numra të revistës “Bujqësia Shqiptare”. Theksojme se botimi i revistës “Bujqësia Shqiptare” është nderprere dhe keto materiale të interesuarit do t’i marrin në rrugë elektronike. Gjithashtu buxheti për keto botime është pakesuar.

**Produkti: Të ardhura nga QTTB-të të realizuara.**

Bazuar në plan biznesit e QTTB-ve po vazhdon puna puna për prodhimin e të ardhurave kryesisht për prodhimin e farave e fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, shpërndarjen e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, realizimin e analizave laboratorike të ushqimit, tokës, hartografinë, etj.

Aktualisht nga QTTB – të janë realizuar dhe shpenzuar 11639.713 mijë lekë të ardhura ose nga 43300 mijë lekë që është limiti i përdorimit të këtyre të ardhurave ose 26 % e planifikimit. Kryesisht realizimi të ardhurave të nente mujorit të vitit 2010 ka ardhur prej shitjes së materialit biologjik nga QTTB Fushë Krujë, shitja e fidaneve në QTTB Lushnje si dhe shitjes së farës së misrit hibrid të gjeneracionit të lartë nga QTTB Shkodër. Theksojme se për vet specifikat e bujqësisë QTTB Lushnje dhe Vlore gjatë muajve Tetor dhe Nentor realizojnë të ardhura kryesisht nga shitja e farës së grurit, fidaneve të pentarise, agrumeve etj.

**Produkti: Bazat eksperimentale prodhuese të rrethuara:** Ky investim i planifikuar të realizohet në masën 1000 metër linear dhe me vlerë 4220 mijë lekë është realizuar nga QTTB Lushnje si punim në masën 100% por janë disbursuar vetëm 1146 ose 44 % e vlerës së prokuruar. Po vazhdojnë procedurat për likuidimin e pjesës së mbetur.

**Produkti : Ndërtimi të reja të QTTB-ve të realizuara.** Ky investim është planifikuar të realizohet në masën 2800 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 9962 mijë lekë. Ky produkt nuk është realizuar pasi QTTB Lushnje dhe Vlore kanë kryer procedurën e tenderimit në muajin Gusht për VKM nr. 591, datë 23.07.2010 ka bllokuar vazhdimin e metejshëm të procedurave. Në vlerën e këtij produkti është përfshirë dhe sasia e investimeve të mbartura të vitit 2009, të cilat deri tani janë likuiduar në masën 100% ose 5925.872 mijë leke.

**Produkti : Ambientet e QTTB-ve të rikonstruara.** Ky investim është planifikuar të realizohet në masën 2000 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 4730 mijë lekë. Vlera e këtij investimi ka ndryshuar dhe aktualisht është 4006, kjo pasi QTTB Korce i ka prokuruar të 2 objektet me vlerë me të ulët. Realizimi 9 mujor i vlerës së këtij produkti është në masën 2389 mijë leke ose 60% . Theksojme se QTTB Korce ka realizuar në masën 100% punimet në të 2 objektet dhe aktualisht ka disbursuar 97% të vlerës totale (është në procedurë likuidimi total) ndërsa diferenca në mosrealizim vjen vetëm si pasoje e bllokimit të procedurave nga VKM nr. 591, datë 23.07.2010 për QTTB Shkodër e cila e ka kryer procedurën e tenderimit në 30.07.2010,

**Produkti : Pajisje laboratorit të blera.** Jane planifikuar të blihen 17 pajisje laboratorit në QTTB-të. Edhe mosrealizimi i këtij produkti vjen si pasoje e bllokimit të procedurave nga VKM nr. 591, datë 23.07.2010 pasi QTTB Shkoder e ka kryer procedurën e tenderimit në 30.07.2010 ndërsa QTTB Lushnje në Gusht 2010 .

**Produkti : Mjete dhe agregate bujqësore të blera.** Per kete produkt ne fillim te vitit kane gene te planifikuar te bliheshin 10 agregate konkretisht nga 2 QTTB Fushe Kruje dhe Lushnje, por QTTB Fushe Kruje nuk e realizoi tenderin per kete objekt per mosofrim pjesemarrësish, prandaj aktualisht fondi perkates eshte zbritur nga fondi i planifikuar ne fillim te vitit. Per rrjedhoje plani i rishikuar per kete produkt eshte 5 agregate ne vleren 2000 mije leke. QTTB Lushnje deri tani nuk e ka disbursuar vleren prej 1932 mije leke (vlera e prokuruar) pasi ka hasur ne vonesa te transportit nderkombetar per marrjen e mallit.

**Produkti: Pajisje elektronike të blera.** QTTB Vlore ka realizuar kete investim si dhe ka disbursuar vleren ne masen 100%

**Produkti :Pajisje dhe orendi për QTTB –të.** QTTB Vlore dhe Fushe Kruje kane realizuar blerjen e pajisjeve dhe orendive. Aktualisht keto QTTB po vazhdojne disbursimet per kete produkt. Theksojme se vetem QTTB Shkoder nuk e realizuar kete produkt pasi e ka kryer procedurën e tenderimit në 30 Korrik 2010 dhe vazhdimi i procedurave eshte bllokuar nga VKM nr. 591, datë 23.07.2010.

**Produkti: Instalim Sistemi Ujitës:** QTTB Fushe Kruje ka perfunduar instalimin e sistemit ujtes por deri tani nuk ka kryer ende disbursimin pasi ky sistem eshte ne prove per marrjen ne dorezim ndërsa QTTB Shkoder nuk e realizuar kete produkt pasi e ka kryer procedurën e tenderimit në 30 Korrik 2010 dhe vazhdimi i procedurave eshte bllokuar nga VKM nr. 591, datë 23.07.2010 .

### ***Shërbimi Këshillimor***

Nga strukturat e Shërbimit Këshillimor gjatë 9 muorit të parë 2010 janë kontaktuar rreth 60000 fermerë direkt në aktivitete ekstensionit ku sigurohet përfshirja e gjithë të interesuarve, përmirësimi i shprehive praktike dhe njohurive të fermerëve.

Gjatë 9 muorit të vitit 2010 janë realizuar 100 ditë trajnime të hapura me specialistët e bujqësisë (publikë edhe privatë), si dhe 900 ditë trajnime me fermerët e interesuar.

Nga QTTB-të në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Këshillimor janë duke u përgatitur 7 tituj broshurash divulgative. Janë shpërndarë për të interesuarit 3000 libra/broshura të prodhuara gjatë viteve.

## **6. Programi “ Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore”**

Realizimi i shpenzimeve 9 mujore për këtë program, që përfaqeson rreth 0,1 përqind të totalit të buxhetit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

Produkti	Buxheti 2010 ne mln leke	Realizimi 9 mujori I 2010		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Trajnim i specialisteve te SAMT-se dhe ZMMT	0,7	0,5	71,4	<b>Pjeserisht</b>
Krijimi i sistemit Lis dhe integrimi GISdhe dixhitalizimi i RTB	6,2	2,5	40,3	Pjeserisht
Pergatitja dhe botimi i akteve ligjore e nenligjore	0,2	0,0	0,0	Aspak
Klasifikimi i tokes bujqesore sipas FAO dhe UNESCO	0,1	0,1	100	Plotesisht
Hartat kadastrale ne komuna	1,3	1,	84,6	Pjeserisht
<b>TOTALI</b>	<b>8,5</b>	<b>4,1</b>	<b>48,2</b>	

Trajnimin e specialistëve të DAMT-ve në qarqe dhe ZMMT-ve në komuna dhe/ose bashki nga 700 mijë lekë të planifikuara, realizuar 480 mijë lekë. Ky produkt do të realizohet plotësisht, pasi kanë mbetur pa u trajnuar edhe 2 qarqe (Fieri dhe Gjirokastra), në varësi të dixhitalizimit të regjistrit të tokës bujqësore në 40 komuna.

**2-Produkti**–Krijimi i sistemit LIS dhe integrimi në GIS dhe dixhitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore nga 6220 mijë lekë të planifikuar, realizuar 2.455 mijë lekë. Për realizimin e kësaj pjese të programit dhe shpenzimet përkatëse për të është caktuar QTTB-ja Fushë-Krujë. Sipas informacionit të ardhur nga QTTB-ja, arsyet e mos realizimit ka qënë ndërprerja e fondeve për shërbime në rrethe (djetat) sipas Urdhërit të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nr. 291, datë 30.9.2010, "Për kryerjen e udhëtimeve të rëndësisë së veçantë" në muajin korrik-shtator të 2010. Pa realizuar kane mbetur rrethi Korcë (1 komunë) dhe rrethi Sarandë (3 fshatra të komunës Xarrë).

**3-Produkti** -harta kadastrale në komuna nga 1280 mijë lekë të planifikuar, realizimi 1100 lekë. Ky produkt vazhdon të realizohet.

**4-Produkti**, përgatitja dhe botimi përmbledhës të akteve ligjore dhe nënligjore nga 200 mijë lekë nuk realizohet pasi është ndërprerë procedurat e tenderimi me VKM nr. 591, datë 13.7.2010.

**5-Produkti** -Klasifikimi i tokës sipas FAO-s/UNESCO nga 100 mijë lekë të planifikuar, është realizuar plotësisht.

## SEKRETARI I PERGJITHSHEM

**Albert KUSHTI**

**Konc. Edlira KOLA**  
**P/sek Beatrice BEZHANI**  
**Drejtor Agron VATA**  
**Drejtor Bislim AHMETAJ**